



Raportim Vjetor

Enkeleda Shehi, Kryetare

Mbi Veprimtarinë e AMF-së gjatë vitit 2012

Përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat

11 mars 2013

Znj. Enkeleda Shehi, kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) paraqet raportin vjetor përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat, në zbatim të nenit 3 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

Kryetar i Komisionit, z. Spaho, nënkryetare e Komisionit, znj. Kodheli, zonja e zotërinj deputetë anëtarë të Komisionit,

Kam kënaqësinë sot të jem para jush për të paraqitur Raportin Vjetor të AMF-së¹, në të cilin përshkruhet veprimtaria e zhvilluar prej Autoritetit gjatë vitit 2012. Në fjalën time këto zhvillime do të paraqiten sipas dy shtyllave kryesore: (i) mbikëqyrja dhe rregullimi i tregjeve financiare nën mbikëqyrje, si dhe (ii) zhvillimi e forcimi institucional i vetë AMF-së.

Misioni i Autoritetit është të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë financiare dhe në zhvillimin e sigurt të tregjeve financiare nën mbikëqyrje për të:

- (i) mbrojtur konsumatorët;
- (ii) nxitur transparencën dhe besueshmërinë e tregjeve financiare, dhe
- (iii) siguruar respektimin e ligjit.

¹ Shih Raporti Vjetor, 2012, AMF.

Ky kuadër shërben për të konturuar punën dhe përpjekjet afatgjata të AMF-së. Në këtë kuptim, objektivat që ne raportojmë në Komision si edhe publikut janë të natyrës afatmesme dhe vit pas viti kryhen detyra e zbatohen projekte, të cilat i shërbejnë përmbushjes së këtyre objektivave afatmesëm.

Objektivat kryesorë të raportuar për vitin 2012 kanë orientuar të gjithë aktivitetin e Autoritetit për vitin 2012 dhe janë përqendruar në:

1. Rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të procesit mbikëqyrës;
2. Përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ;
3. Forcimin e pavarësisë dhe transparencës së AMF-së;
4. Rregullimin efektiv të tregut të detyrueshëm motorik;
5. Zhvillimin teknologjik për të mbështetur aktivitetin e mbikëqyrjes.

Më lejoni që në vijim të informoj, së pari për veprimtarinë e mbikëqyrjes dhe rregullimit.

1. Tregjet financiare nën mbikëqyrje

AMF mbikëqyr tregje financiare që, sipas vlerësimeve,² për vitin 2012, arritën një total aktivesh prej 37.3 miliardë lekë ose 2.8% të PBB-së, nga 1.45% mesatarisht për periudhën 2007-2011 dhe me pjesëmarrjen aktive të 38 operatorëve të licencuar si shoqëri dhe 387 operatorëve të licencuar si individë profesionistë. Përtej shifrave sasiore, është e rëndësishme të theksohet se:

- Këto tregje janë të natyrave të ndryshme dhe kërkojnë ekspertizë të shumëllojshme për t'i rregulluar dhe mbikëqyrur;
- Prirja e vazhdueshme është zgjerimi i veprimtarisë dhe shtimi i numrit të operatorëve në treg duke plotësuar gradualisht praktikën e biznesit;
- Mbikëqyrja realizohet me një numër relativisht të kufizuar punonjësish të organizuar sipas një strukture cila është e pandryshueshme prej disa vitesh. *(Kjo strukturë prej vitesh ka humbur fleksibilitetin dhe nuk mbështet nevojat e institucionit për ndryshime në përputhje me kërkesat për forcimin e kapaciteteve administrative, përshtatjen me zhvillimet në tregje, si dhe përmbushjen e misionit të nxitjes së qëndrueshmërisë financiare.)*

² Referohemi si vlerësime, sepse të dhënat përfundimtare do të raportohen pasi të jenë audituar pasqyrat financiare të subjekteve të mbikëqyrura.

1.1 Tregu i sigurimeve

Tregu i sigurimeve prej vitesh ruan peshën më të madhe në tregjet financiare nën mbikëqyrje dhe, për rrjedhojë, merr një pjesë të konsiderueshme të burimeve të AMF-së. *(Megjithatë, zhvillimet në tregun e letrave me vlerë, siç do e theksoj në vijim, kanë ndryshuar disi strukturën në treg.)* Totali i aktiveve të tregut të sigurimeve përbën rreth 56.2% të tregjeve financiare nën mbikëqyrje, nga 99.2% që ishte një vit më parë (shifra operative 2012). Në vitin 2012 tregu u shtua me një shoqëri të re sigurimi dhe vërehet që vit pas viti rritet numri i profesionistëve të licencuar, zhvillime të cilat tregojnë se ka interes për hyrje të operatorëve në treg. Kjo prirje mbështetet nga politika që zbaton në tërësi AMF, pra edhe për dy tregjet e tjera, për licencim shoqërisht apo profesionistësh, të cilët përmbushin kushtet ligjore, pa vënë kufizime apo pa caktuar preferenca të tjera.

Veprimtaria e tregut të sigurimeve është zgjeruar krahasuar me një vit më parë, e matur me primet e shkruara bruto, që kanë arritur në 8.95 miliardë lekë, afërsisht 9% më shumë sesa një vit më parë. Ky zgjerim aktiviteti në tërësinë e tij shfaq të njëjtën strukturë si edhe një vit më parë. Kështu,

- rreth 89.9% të totalit të primeve të shkruara bruto e zënë sigurimet e Jo-Jetës, ndërsa në sigurimin e Jetës volumi i primeve të shkruara bruto ishte rreth 9.8%;
- raporti ndërmjet sigurimeve të detyrueshme dhe atyre vullnetare duket se mesatarisht luhatet rreth 1 (51.1%:48.9% në vitin 2012 kundrejt 45%:55% në vitin 2011), gjë e cila ndikohet kryesisht prej luhatjeve të çmimeve të MTPL si rrjedhojë e liberalizimit;
- primi për frymë mesatarisht rezulton në rreth 3,172 lekë (22.8 euro) ose 261 lekë më shumë se në vitin 2011, pjesa më e madhe e së cilës, mbi 88%, vazhdon të shpenzohet për sigurimin e Jo-Jetës;
- primet e shkruara bruto të Jo-Jetës, ndryshe nga viti 2011 gjatë të cilit shënuan rënie prej 0.6%, në vitin 2012 shënuan rritje prej 10.9%, ndërkohë që pjesa më e madhe e tyre, rreth 63.7%, i përket sigurimit motorik. Në vetvete rritja në primet e sigurimit motorik është diktuar kryesisht nga produkti MTPL e brendshme;
- gjatë vitit 2012, shoqëritë e sigurimeve paguan rreth 2.82 miliardë lekë dëme³, ose rreth 26.7% më shumë se në vitin 2011. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimeve motorike me 2.13 miliardë lekë, apo 75.5% të totalit. Veçanërisht në sigurimin MTPL e brendshme, vihet re një rritje e dëmit mesatar të paguar, në masën 34.8%.

Pavarësisht nga ky zgjerim shkalla e penetrimit të sigurimeve (primi i shkruar bruto në % ndaj PBB-së) mbetet ende i ulët në nivelin 0.67%, diçka më e lartë se një vit më parë (0.62%). Nga ana tjetër, raporti dëme / prime neto të sigurimeve të Jo-Jetës, ndonëse në nivel të ulët prej

³ Dëme të paguara bruto.

35.77%, është rritur me 15.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës. Ky raport është ulur në krahasim me nivelin prej 42.97% vitin 2011 si rrjedhojë e rritjes së primeve të fituara neto dhe mbajtjes në të njëjtin nivel të shpenzimeve për dëmet e paguara. Gjatë vitit 2012 raporti dëme / prime në DMTPL shfaq tendencë në rënie krahasuar me fundin e vitit 2011, por tregon një rritje të ndjeshme krahasuar me vitet 2008-2010. Ndërsa raporti i shpenzimeve Jo-Jetë paraqet një prirje relativisht përmirësuese duke u ulur në nivelin prej 64.7%, nga 74.2% që ishte një vit më parë, si rrjedhojë e rënies më të lartë të shpenzimeve gjithsej (të shkaktuar nga reduktimi i shpenzimeve të marrjes në sigurim) krahasuar me rënien në primet e shkruara bruto⁴.

1.2 Tregu i letrave me vlerë

Zhvillimi më i spikatur në tregun e letrave me vlerë për vitin 2012 lidhet me veprimtarinë e ushtruar nga dy fonde investimi, në lekë dhe në euro, të cilët në më pak se një vit arritën një nivel prej 16.01 miliardë lekë (114 mln euro) asete nën administrim, ose 43% të aktiveve gjithsej të tregjeve nën mbikëqyrje, dhe 10,962 anëtarë. Një dinamikë e tillë rritjeje rithekson potencialin për zhvillim të tregjeve financiare në vend. Portofoli i investimit të këtyre fondeve dominohet kryesisht nga investimet në obligacione të Qeverisë, të cilat përbëjnë gati 71.6% të aseteve neto.

Segmenti tjetër aktiv në tregun e letrave me vlerë mbetet tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë (bono thesari dhe obligacione), i cili mbizotërohet më së shumti prej instrumenteve afatshkurtër, 77.95% të vlerës e 97.1% të numrit gjithsej të transaksioneve i përkasin bonove të thesarit, dhe pjesa që mbetet i përket instrumenteve afatgjata.

Viti 2012 shënoi vitin e gjashtë të menaxhimit nga AMF në mënyrë të suksesshme të platformës GSRM, e cila siguron transparencë në lidhje me kuotimet dhe transaksionet e tregut me pakicë të letrave me vlerë. Të drejtën për të operuar në platformën GSRM e kanë 9 operatorë të licencuar, që përfaqësohen nga 8 banka dhe Posta Shqiptare.

Në tregun e letrave me vlerë operojnë një shoqëri administruese e fondeve të investimeve, 13 shoqëri komisionere, 8 kujdestarë të letrave me vlerë, Qendra e Regjistrimit të Aksioneve dhe Bursa e Tiranës, si edhe 18 broker individë që veprojnë në emër të shoqërisë komisionere. Gjithashtu, gjatë vitit 2012 AMF miratoi prospektet për emetime obligacionesh me ofertë private, të parat e këtij lloji në vend. Siç vërehet, tregu i letrave me vlerë gradualisht po plotësohet me operatorë dhe produkte.

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit në vitin 2012 u miratua rregullorja “Për kushtet e organizimit dhe funksionimit të platformës së tregtimit shumëpalësh” (MTF) dhe u ndryshua rregullorja për licencimin e Bursës, që krijojnë mundësi për zhvillimin e tregut. MTF është një

⁴ Të dhënat janë sipas pasqyrave financiare nëntëmuajore, pasi ende nuk është mbyllur viti financiar.

platformë me kërkesa më lehtësuese në krahasim me listimin zyrtar në Bursë, ndërsa për Bursën u hoqën kufizimet që ekzistonin në lidhje me strukturën aksionare të saj.

Tregu i aksioneve vazhdon të mbetet ende i pazhvilluar. Për këtë arsye në vitin 2013 AMF ka marrë nismën për të shqyrtuar mundësinë e hartimit të një strategjie për zhvillimin e tregut të letrave me vlerë, zbatimi i së cilës kërkon angazhimin dhe mbështetjen edhe të aktorëve të tjerë.

1.3 Tregu i pensioneve private vullnetare

Tre fondet e pensionit arritën gjatë vitit 2012 një total asetesh neto prej 283 milionë lekë (2.03 milionë euro), me një rritje prej afro 83%, si dhe një numër anëtarësh prej 7,281, ose 16% më tepër se në vitin 2011. Që të mbështetet kjo dinamikë rritjeje, tregu i pensioneve private vullnetare ka ende nevojë për nxitje, bazuar në praktikën e njohura që kanë dhënë ndikime pozitive në vende të tjera. Konkretisht, vlerësojmë të nevojshme zbatimin pa kufizim të lehtësive tatimore për individët që përfshihen në këto skema, ashtu si ato janë parashikuar në Ligjin “Për fondet e pensionit vullnetar”. Kufizimet aktuale të përcaktuara në ligjin për tatimet mbi të ardhurat kanë cenuar interesat e shumë individëve që tentuan të futen në skemat e pensionit vullnetar.

Në vitin 2013, AMF do të punojë për të ndërtuar një platformë pune për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për përfitimet që ka nga pjesëmarrja në skema të tilla, në zbatim edhe të kërkesës së Kuvendit⁵ për nxitjen e fushatave edukuese, që synojnë rritjen e ndërgjegjësimin për përfitimet nga produktet dhe shërbimet financiare. Po kështu, në projekt është edhe harmonizimi i plotë i legjislacionit përkatës me direktivat e BE-së, për t’i dhënë njëkohësisht më tepër frymëmarrje nxitjes së planeve profesionale dhe unifikimit të praktikave plotësisht me ato evropiane. Amendimet pritet të jenë gati gjatë vitit 2013 dhe për këtë nevojitet mbështetja dhe miratimi juaj.

2. Mbikëqyrja e tregjeve financiare

Siç e theksova më lart, burimet e mbikëqyrjes së tregjeve financiare, i dedikohen kryesisht tregut të sigurimeve, si segmenti më i zhvilluar. Vazhdimisht kemi raportuar për disa projekte afatmesme në kuadër të objektivit për rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të procesit mbikëqyrës, të cilat kanë patur në vëmendje tregun e sigurimeve. Aktualisht projekte si mbikëqyrja me fokus riskun dhe menaxhimi i sistemit të informacionit janë përfunduar dhe kanë hyrë në fazën e zbatimit. Ky proces është shoqëruar edhe me një sërë përmirësimesh të teknologjisë së informacionit për të përmbushur objektivin tjetër atë të mbështetjes së mbikëqyrjes me teknologji informacioni. Në vijimësi fokusi i AMF-së do të jetë në zbatimin e Planit Strategjik për mbikëqyrjen efektive, sistemin e paralajmërimit të hershëm për tregun e sigurimeve, si dhe transferimin e përvojës dhe njohurive të fituara deri më tani për ndërtimin e kapaciteteve

⁵ Shih rezolutën e Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së AMF për vitin 2011.”

mbikëqyrëse sipas metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus riskun në tregun e letrave me vlerë dhe të fondeve të pensioneve vullnetare private.

Gjatë vitit 2012 janë ndjekur në vijimësi treguesit teknikë e financiarë të shoqërive të sigurimit, si dhe janë kryer inspektime në vend e janë marrë masa korrigjuese. Në procesin e analizës financiare është konkluduar që në tregun e sigurimeve provigjonet teknike (detyrimet ndaj të siguruarve) **janë të mjaftueshme** dhe në çdo kohë **mbulohen me aktive të përshtatshme** për jo më pak se vlera bruto e tyre; treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit është 128.4% që flet për një **treg të mirëkapitalizuar**; fondi i garancisë është në nivelin 4.7 miliardë lekë, i cili **zotërohet sipas kërkesave të ligjit**.

Inspektimi në vend është përqendruar në vlerësimin e aftësisë paguese aktuale dhe të pritshme të shoqërive krahasuar me profilin dhe kapacitetin mbajtës të riskut. Gjatë vitit 2012 janë kryer 31 inspektime, kryesisht inspektime të plota të planifikuara, prej të cilave 10 u përkasin shoqërive të sigurimit. Mbi bazën e gjetjeve nga inspektimet e kryera në shoqëritë e sigurimeve, AMF ka dhënë rekomandime në lidhje me administrimin e rrezikut; vlerësimin dhe menaxhimin e dëmeve; raportimin në Autoritet; vlerësimin dhe përgjegjësinë e komiteteve të kontrollit të brendshëm, si dhe nevojat për përmirësim të politikave, procedurave dhe standardeve teknologjike që lidhen me sigurinë e sistemeve të informacionit. Ndërsa inspektimet e kryera në fondet e pensioneve vullnetare private dhe shoqëritë administruese të tyre përgjithësisht kanë evidentuar probleme dhe janë dhënë rekomandime në lidhje me sistemet e informacionit dhe me raportimet.

Nga inspektimi në Byronë Shqiptare të Sigurimeve (BSHS) u evidentuan probleme që lidhen me vonesa në pagimin e dëmeve, për llogari të Fondit të Kompensimit (FK), si dhe mangësi në ngritjen dhe ndjekjen e padive të regresit. Për periudhën 2001-tetor 2012 BSHS për llogari të FK ka paguar për 1,625 praktika dëmsh një vlerë prej rreth 878.6 milionë lekë. Paditë e regresit janë ngritur vetëm për rreth gjysmën e praktikave dhe të vlerës, si dhe janë arkëtuar vetëm 3% e shumës së paguar.

E gjykova të nevojshme të trajtoj më hollësisht këtë problematikë për shkak të vëmendjes së konsiderueshme që ka patur gjatë vitit 2012. Bordi i Autoritetit, në zbatim edhe të kërkesës së Kuvendit për marrjen e masave për përmirësimin e raportit dëme/prime për rritjen e besimit të konsumatorit dhe përmirësimin të shërbimit, ka marrë vendimin për rritje të FK për shlyerjen e detyrimeve. Efekti që dëmet e paguara nga FK gjatë vitit 2012 kanë në raportin dëme/prime të tregut vlerësohet rreth 3.7% (nga rreth 4% një vit më parë). Kjo çështje do të vijojë të trajtohet me përparësi edhe për vitin 2013.

Në përfundim të procesit mbikëqyrës (analizës dhe inspektimeve) Bordi ka marrë 8 vendime për marrje masash administrative, zbatimi i të cilave ndiqet në vijimësi. Prej këtyre masave, 1 është ankimuar në rrugë gjyqësore dhe gjatë vitit 2012, AMF ka qenë palë ndërgjyqëse në 17 çështje

gjyqësore gjithsej. Ankimimi i vendimeve çon në pezullim të zbatimit të vendimeve të Autoritetit. Ky proces, i kombinuar edhe me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e tij, cenon deri diku efektivitetin e procesit mbikëqyrës.

3. Nxitja e qëndrueshmërisë financiare

AMF, së bashku me anëtarët e tjerë të Grupit Këshillimor për Stabilitetin Financiar (GKSF), përkatësisht Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë dhe Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, kanë bashkërenduar veprimet në lidhje me trajtimin e problematikave të sektorit financiar në Shqipëri. Gjithashtu, është punuar për të hartuar planet e posaçme të veprimit dhe mbi bazë të këtyre planeve ka edhe rekomandime për secilin institucion. Në këtë kontekst në AMF u shqyrtua profili i rrezikut në tregun e sigurimeve, letrave me vlerë dhe fondeve të pensioneve vullnetare private, që janë tregjet financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së dhe u arrit në përfundimin që në gjendjen aktuale të zhvillimit të tyre, këto tregje nuk mund të shndërrohen në rreziqe sistemike serioze për sistemin financiar në tërësi. Bazuar në rëndësinë që ka qëndrueshmëria financiare, në vitin 2013 në AMF do të zbatohet projekti për konceptimin e një plani të posaçëm veprimi në situata të jashtëzakonshme, i cili do të jetë pjesë përbërëse e një plani më të gjerë për bashkërendimin e veprimeve me Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë dhe Agjencinë e Sigurimit të Depozitave në situata të mundshme krizash.

4. Zhvillimi institucional i AMF-së

Objektivi për forcimin e pavarësisë dhe të transparencës i shërben zhvillimit institucional të AMF-së. Forcimi i pavarësisë është rekomanduar me forcë prej disa vitesh nga Banka Botërore, si edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Në tre vitet e fundit, Komisioni Evropian në Raportin e Progresit, ka patur si konstante kërkesën për forcimin e kapaciteteve administrative të AMF-së. Në përmbushje të këtij objektivi në AMF u shqyrtuan në mënyrë të kujdesshme literatura ndërkombëtare që trajton çështjet e pavarësisë së rregullatorëve të sektorit financiar, si dhe parimet dhe kriteret ndërkombëtare të IAIS-it, IOPS-it dhe të IOSCO-s dhe u përgatit vlerësimi përkatës për nivelin e pavarësisë së AMF-së. Nga ky shqyrtim rezultoi që *AMF në tërësi ka nevojë të forcojë pavarësinë, por kufizimet më thelbësore i ka në përmasën financiare apo operacionale të pavarësisë. Janë këto kufizime që kanë çuar në probleme me strukturën organizative, tërheqjen, mbajtjen dhe trajnimin e vijueshëm të punonjësve të kualifikuar, si dhe kryerjen e nevojshme të investimeve.* Problemet teorike dhe praktike në lidhje me pavarësinë e rregullatorit të sektorit financiar u bënë pjesë e diskutimeve të konferencës së parë ndërkombëtare që organizoi AMF, me ekspertë të ftuar nga SHBA dhe Evropa, drejtues të lartë të autoriteteve rregullatore homologe, e cila u përshëndet nga Kryeministri i vendit dhe kreu i Delegacionit të BE-së në Shqipëri. Kjo konferencë u shndërrua në një forum të rëndësishëm diskutimesh ndërmjet kolegësh dhe mbi këtë bazë AMF përgatiti dhe paraqiti në Qeveri, në muajin dhjetor të vitit 2012, disa ndryshime për ligjin e AMF-së. Këto ndryshime konsistojnë në *forcimin e pavarësisë së AMF-së, sidomos të përmasës financiare*, si dhe përfshirjen e

dispozitave të reja që do të shërbejnë si *mekanizma mbrojtës që pavarësia të mos cenohet* në të ardhmen.

Gjej rastin të theksoj domosdoshmërinë e miratimit të këtyre propozimeve dhe të shpreh besimin që do të kemi mbështetjen e duhur nga anëtarët e nderuar të këtij Komisioni dhe nga deputetët në tërësi.

Duke kërkuar forcimin e pavarësisë së AMF-së, nga ana tjetër jemi të vetëdijshëm edhe për nevojën e forcimit të përgjegjshmërisë së institucionit. Në ndryshimet ligjore të propozuara gjithashtu ka disa dispozita që çojnë në forcimin e përgjegjshmërisë. Përveç kësaj, në vitin 2012, në AMF u hartua strategjia e komunikimit me median në funksion të rritjes së transparencës insitucionale. Gjatë këtij viti, për aktivitetet e rëndësishme të organizuara nga AMF, mediat vizive ka organizuar edhe transmetime të drejtpërdrejta. Pasqyrimi i këtyre aktiviteteve të rëndësishme është bërë edhe në media rajonale, që janë të specializuara në pasqyrimin e veprimtarive në tregun e sigurimeve dhe pensioneve private në të gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore. Tematikat kryesore nën mbikëqyrjen e AMF-së, të cilat lidhen edhe me mbrojtjen e konsumatorit, janë pasqyruar në mbi 160 prezantime në gazetatat kryesore të përditshme në vend, si dhe në mbi 50 dalje në televizionet me mbulim kombëtar dhe rajonal.

Në përmbushje të objektivave të parë dhe të dytë në AMF janë zbatuar një numër i konsiderueshëm projektesh dhe ka një plan projektesh po kaq ambicioz për vitin 2013, në bashkëpunim me BB, USAID/FSVC, TAIEX. Ky numër i konsiderueshëm projektesh është mundësuar falë seriozitetit që ka treguar AMF për thithjen e tyre dhe korrektesës e profesionalizmit të punonjësve të saj në zbatimin e projekteve. Në këtë mënyrë AMF është shndërruar në një institucion që ka kontribuar në sjelljen në Shqipëri të fondeve (mbështetja financiare e projekteve), si dhe të eksperimentit në masë të konsiderueshme.

Marrëdhëniet me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, sidomos me organizatat ndërkombëtare dhe nismat rajonale në të cilat jemi anëtarë, tashmë kanë krijuar një traditë të qëndrueshme dhe janë të dobishme. Në disa prej aktiviteteve të zhvilluar AMF ka pjesëmarrje aktive duke moderuar diskutimet mbi çështje të natyrave të ndryshme.

Në përfundim të fjalës time dua të theksoj se të gjitha ndryshimet ligjore dhe rregullatore janë ndërmarrë në përmbushje të kërkesës së Kuvendit për plotësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor, në veçanti atij nënligjor në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i MSA-së, direktivat e BE-së dhe praktikave të vendeve të veçanta evropiane. Në vijim të kësaj do të doja të kërkoja edhe njëherë mbështetjen tuaj për të votuar projektligjet dhe projektamendimet e ligjeve të propozuara nga AMF për veprimtarinë në fushën e sigurimeve dhe risigurimeve, të sigurimit të detyrueshëm dhe për AMF-në në një kohë sa më të shpejtë, me qëllim që të përmbushim, si detyrimet që kemi në procesin e integritimit në BE, ashtu edhe për të vijuar me zbatimin e strategjive dhe të

projekteve që çojnë në përmbushje të objektivave për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ dhe të rritjes së cilësisë e të efektivitetit mbikëqyrës.

Gjithashtu i përcjell një falenderim stafit të AMF-së, për përkushtimin dhe profesionalizmin e shfaqur, në realizimin e objektivave dhe përballimin e sfidave që paraqesin tregjet financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së.

Ju faleminderit për vëmendjen. Është kënaqësia ime të diskutojmë bashkërisht për çështjet të veçanta dhe të jap përgjigje e sqarime për pyetjet që mund të keni.